

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit H.B, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.337/2016 të dt.15.07.2016, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.07.2017, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit - Armend Hamiti dhe i pandehuri H.B, gjykata mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: H.B, i biri i Sh dhe Sh, e gjinisë R, i lindur me dt.*data e lindjes*, nga fshati N, Komuna S, me vendbanim në fshatin N, komuna S, me vendbanim të përkohshëm në S në qytetin B, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, punon zdrukthtar, në shteti e Suedisë me nr. personal *numer personal*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me dt. 24.06.1966, rreth orës 19:45, i pandehuri pa autorizim ka poseduar armë në atë mënyrë që ka arritur në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, nga Geteborgu i Suedisë nga ana e pilotit janë lajmëruar policia se i pandehuri posedon pushkë ajrore dhe pas kontrollit i është gjetur dhe sekuestruar një pushkë ajrore me nr. serik 0281215 e kalibrit 4.5, prodhuar në Spanjë si dhe tre kutia me 1313, diabolla (fishekë të pushkës ajrore), të cilën e mbante pa autorizim.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,46,69,73,74,75, të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit **H.B**, i caktohet dënim me gjobë **prej 500 (pesëqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar t’ a paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë ashtu që në ditë burgimi do të llogaritet me 20 euro gjobë të shqiptuar.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: pushkë pneumatike cal. 4.5 dhe kuti Diabolla cal. 4.5

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.337/2016, të datë 15.07.2015, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin H.B, për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me datë 05.07.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr.337/2017, të datë 15.07.2015, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykses pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenet 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri H.B, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë por nuk e ka ditur që është e kundërligjshme mbajtja e pushkës ajrore në Kosovë pasi që në Suedi kishte qenë e lajmëruar dhe nuk kërkohej leje specifike për mbajtjen e asaj arme. Të njëjtën e kishte lajmëruar atje në aeroport andaj edhe piloti i aeroplanit kishte pasur njohuri dhe këtë ja ka transmetuar edhe zyrtarëve të Aeroportit “Adem Jashari”. I pandehuri ka kërkuar nga Gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë duke u bazuar në rrethanat si ka ndodhur vepra.

Prokurori i Shtetit -Armend Hamiti ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me provat e paraqitura në aktakuzë. Se i akuzuari si në fazat e më hershme edhe në gjykatë në mënyrë të vullnetshme ka pranur se ka pasur armë në posedim. Atëher e ka shprehur se e ka pas të lajmëruar por nuk e ka ditur se në Kosovë është veprë inkriminuese, andaj pranimi i fajësisë është në përputhje me ligjin dhe si e tillë ka propozuar që të pranohet nga ana e gjykatës. Gjithashtu ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor për këtë veprë penale dhe me rastin e matjes së dënimit si rrethanë lehtësuese gjykata të merr pranimin e fajësisë dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: procesverbal i dëshmisë i datës 24.06.2016, fotografitë e armës së konfiskuar si dhe shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenet 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, se i njëjti është baba i katër fëmijëve, dhe i pranuar mirë në rrethin e tij social, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenet 69 të KPRK-së dhe 115 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenet 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.424 /16, datë 05.07.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.